REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 850/20
Datë/Datum. 30.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksper. shqyrtues dhe nënshkrimi:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*
Ermal Shala:	26/10/2020	30/10/2020	*850/20*

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.10.2020, **OE "HAXHIJAHA TRADE" SH.P.K. – Rahovec**, ka parashtruar ankesë me nr: 850/20, kundër njoftimit për shpërblim me kontratë dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër **"KRMC-20-5508-1-2-1"**, me titull **"Furnizim me goma dhe akumulator"**, iniciuar nga **AK – KRM ÇABRATI – Gjakovë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **23,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 21.09.2020
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 01.10.2020
Vendimi i AK-së dhe letrat standarde: 14.10.2020
Kërkesa për rishqyrtim pran AK: 14.10.2020
Pezullimi i Aktivitetit: 15.10.2020
Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim: 19.10.2020
Ankesa në OSHP: 23.10.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE "HAXHIJAHA TRADE" SH.P.K. – Rahovec, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.

Neni 7 i LPP-së – Barazia dhe Trajtimi, pika 1,2,3
Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, pika 1,2,3
Neni 52 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, pika 1 dhe 2
Neni 60 – Kriteret për dhënien e Kontratës, pika 1.1

Haxhijaha Trade shpk për procedurën e Prokurimit KRMC-20-5508-1-2-1, Furnizim me goma dhe Akumulatora të datës 01.10.2020 ka ofruar çmimin e Tenderit 24.711,10 Euro ndërsa Tenderuesi i dytë ka ofruar çmimin e Tenderit 25.757,12 Euro. Në këtë procedurë të prokurimit KRITERI PËR DHËNIEN E KONTRATËS KA QENË ÇMIMI MË I ULËT dhe në këtë rast Haxhijaha Trade shpk ka ofruar çmimin më të ulët dhe ka qenë e përgjegjshme.

Pretendimet tona ankimore parashtrohen për arsye se AK Çabrati ka refuzuar ofertën tonë, pranë faktit që oferta jonë ka qenë me çmimin më të ulët dhe ka qenë plotësisht e përgjegjshme, duke marrë vendimin për ta shpërbly tenderuesin që ka ofru çmimin më të lartë në vlerë 25.757,12 Euro. AK Çabrati këtë vendim të tyre e kanë arsyetu se Haxhijaha Trade ka ofru 4 artikuj (nga gjithsej 42) me numër rendor 24, 25, 26 deh 27 me çmimin më të lartë.

Ne e kemi dhënë sqarimin për këta katër artikuj (pikja, ngjitja, montimi - çmontimi i gomave të SKIP-it). Puna mbi pikjen e gomave të SKIP-it, kërkon angazhimin e fuqisë shtesë punëtore si dhe kohë më shumë gjatë montimit dhe çmontimin për shkak të natyrës së punës, peshës së gomave dhe kompleksit të punës në këto goma gjatë montim-çmontimit, përderisa dallon rasti i pikjes së gomave për vetura, sikurse që dallon edhe çmimi në ofertën tonë në krahasim me çmimet e SKIP-it.

Së dyti, AK Çabrati nuk ka kërku **peshimin e çmimit të artikujve,** me çka konsiderojmë se AK ka dalë jashtë kornizave të parashtruara në këtë procedurë të prokurimit.

Së treti, çmimet tona të ofruara janë në korelacion me çmimet aktuale të tregut të sotshëm, dhe referimet viteve paraprake, 2013 ...etj nuk mund të përputhen me rrethanat e sotme.

Refuzimi i ofertës tonë bie ndesh me Nenin 60 pika 1,1 **Kriter për dhënien e Kontratës çmimi më i ulët.** Në këtë procedurë nuk është kërkuar kriteri për dhënien e kontratës ekonomikisht më i favorshëm konform Nennit 60 1,2 por është kërkuar kriteteri për dhënien e Kontratës çmimi më i ulët konform Nenit 60 1,1.
Refuzimi i ofertës tonë bie ndesh me Nenin 7 pika 1, 2, 3 BARAZIMI NË TRAJTIM.. si edhe neneve që i kemi përmendur më lartë.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Operatori Ekonomik duhet ti përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).	**Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.**
Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).	**Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës**
Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i	**Vërtetim nga Gjykata kompetente**

falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar)	
Përshtatshmëria profesionale Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)
Certifikata e numrit fiskal	Certifikata e numrit fiskal (kopje).
Certifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK	Certifikata e TVSH (kopje)
Kapaciteti ekonomik dhe financiar Operatori ekonomik duhet te ofroje deshmi te kenaqshme Autoritetit Kontrakutes se qarkullimi vjetor apo pasqyrat financiare te OE gjate tri viteve te fundit fiskal kane qene prej jo me pak se 46,000.00 Euro	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Deklaratat Tatimore vjetore te dorezuara ne Administraten Tatimore
Kapaciteti teknik dhe professional Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të cilat dëshmojnë se ka kryer furnizime të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mire të furnizimeve – (së paku dy referenca ose raport të pranimit të furnizimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar)
Operatori Ekonomik duhet te lëshoj një deklarate qe Oferta e tij eshte konform kërkesave te specifikacionit teknik Aneksi 1	Deklarate e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik
Operatori Ekonomik duhet te ofroj katalog me fotografi dhe specifikacion teknik detal për produktet e ofruara	Katalog me fotografi dhe specifikacion teknik detal për produktet e ofruara- Te vulosur dhe te nënshkruar nga OE
Certifikatat me ISO standard ISO 9001 2015 për produktet e ofruara	Certifikatat me ISO standard ISO 9001 2015 - Kopje
Operatori Ekonomik duhet te këtë se paku një vend shitjeje (pronësi apo Marrëveshje me qera) ne rajonin e Gjakovës	Deklarate me shkrim nga Operatori Ekonomik i cili ka një vend shitjeje (ne pronësi apo marrëveshje me qera) ne rajonin e Gjakovës duke e deshmuar me dokumente te pronesise apo marreveshje me qera

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI-VLERËSUES

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "HAXHIJAHA TRADE" SH.P.K. – Rahovec**, me nr: **850/20**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"KRMC-20-5508-1-2-1"**, respektivisht atij me titull **"Furnizim me goma dhe akumulator"**, iniciuar nga AK – **KRM ÇABRATI – Gjakovë.**

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenët 6, 7, 59, 60 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE Haxhijaha Trade shpk lidhur me anulimin e ofertës së tyre nga AK KRM ÇABRATI në Gjakovë për cimimin e ofertës sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me RROUP dhe LPP. Andaj pretendimi ankimor i OE se ka dorëzuar ofetën me cmimin më të ulët në vlerë 24,711.10 € ndëra AK në kundërshtim me nenin 6, nenin 7, të LPP ka shpallur fitues OE i cili është me çmimin më të lartë me vlerë 25,757,12 €. Ky pretendim **është i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 2:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE Haxhijaha Trade shpk mbi shkeljen e Nenin 51 Njoftimi i Kritereve të përzgjedhjes pika 1,2,3 sqaron se AK KRM ÇABRATI ka vendosur kriteret në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të cilat janë të verifikuara në NJK, DT për këtë procedurë të prokurimit. Ky pretendim **është i pa bazuar**

Përgjigje në pretendimin ankimor 3:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE Haxhijaha Trade shpk mbi shkeljen e Nenin 52 Njoftimi i Kritereve për dhënien e kontratës pika 1,2 sqaron se AK KRM ÇABRATI ka vendosur kriteret për dhënien e kontratës të cilat janë të verifikuara në NJK, DT për këtë procedurë të prokurimit. Ky pretendim **është i pa bazuar**

Përgjigje në pretendimin ankimor 4:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE Haxhijaha Trade shpk, sqaron se AK dhe komisioni vlerësimit kanë vepruar në kundërshtim me Nenin 59 pika 4 dhe Neni 60 në këtë procedurë të prokurimit, AK KRM ÇABRATI ka vendosur si kriter në NJK dhe DT se Autoriteti Kontraktues do ti jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët,** ndërsa përkundër informacione shtese dhe plotësuese nga OE Haxhijaha Trade shpk, AK dhe komisoni vlerësimit nuk kanë vlerësuar ofertën e OE si ofertë financiare me vlerë totale mirëpo në kundërshtim me kriteret e NJK, DT kanë llogaritur çmime për disa artikuj. Eksperti shqyrtues teknik sqaron se në rastin konkret kemi një kontratë me një listë të cmimeve dhe sasive e planifikuar sipas kërkesave nga njësia kërkuese. AK dhe komisoni i vlerësimit duhet të kryejnë vlerësim profesional në përputhje me Nenin 59 pika 4 dhe Nenin 60. Ky pretendim **është i bazuar**

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisoni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit duhet të kryejn vlerësim profesional duke respektuar nenët 6, 7, 59, 60 të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në ketë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet **si pjesërisht të bazuar** dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim** për këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: KRM ÇABRATI – Gjakovë
- Panelit Shqyrtues OSHP
- OE ankues HAXHIJAHA TRADE SH.P.K. – Rahovec